DEKRET
Nr. 455, datë 5.12.2025

PËR DHËNIE DEKORATE

Në mbështetje të nenit 92, germa "ç", nenit 93 të Kushtetutës, nenit 6, pika 1 të ligjit nr. 93/2022, "Për dekoratat në Republikën e Shqipërisë", me propozim të Kryeministrit,

DEKRETOJ:

Neni 1
Dhënien e dekoratës "Kalorës i Urdhrit të Skënderbeut"
zotit Ajet Jata

"Në vlerësim të shërbimit të spikatur, kontributit në zhvillimin dhe drejtimin me vizion dhe përkushtim të njësive elitare të Forcave të Armatosura. Për përfaqësimin me dinjitet të Shqipërisë dhe Forcave të Armatosura në misione dhe operacione të NATO-s. Në nderim të një karriere të ndërtuar me integritet, profesionalizëm dhe përkushtim ndaj atdheut".

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENT I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj